



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 20.07.2023,
me vendim Nr. 01/833-2023, ka miratuar:**

Rishpalljen e konkursit për kompoziminë e melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do të realizoj një melodi të përhershme identifikuese për KQZ-në e cila do të jetë përfaqësuese me misionin e saj.

Melodia do të përmbajë një tekst të kompozuar në melodi që tregon domethënien dhe misionin e KQZ-së.

Melodia do të jetë një lloj himni për institucionin i cili do ta identifikoj dhe përfaqësojë KQZ-në.

Synimi i realizimit të melodisë është që të gjitha produktet dhe informatat të cilat transmetohen dhe publikohen përmes audio dhe videove të përcjellën me melodinë e KQZ-së.

Realizimi i melodisë ka për qëllim që gjatë dhënies se informatave të përcjellura me anë të melodisë të tërheqë dhe të mbajë vëmendjen e dëgjuesëve që informacionet janë nga KQZ.

Qëllimi i melodisë së përhershme është që të identifikon dhe përfaqëson KQZ - në gjatë dhënies se informatave dhe realizimit të produkteve të saj përmes audio dhe video mesazheve.

KQZ-ja do të realizoj kompozimin e një melodie e cila synohet të jetë reprezentues me misionin e sajë dhe që do të përdoret për të gjitha proceset zgjedhore dhe aktivitetet të tjera.

Melodia duhet të ketë një ritëm dhe tingull unik dhe original e cila tregon domethënien dhe misionin e KQZ - së.

Gjatësia e kompozimit duhet të zgjasë jo më pak se 40 deri në 60 sekonda.

Kompozimi nuk duhet të jetë i ngjashëm me ndonjë melodi apo këngë e cilit do vend, cilëndo parti politike, apo cilit do institucion të Republikës së Kosovës.

Teksti për “Melodinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” është:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur, që organizon zgjedhjet e përgjithshme, lokale, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i fton qytetarët, të zgjedhin sipas bindjes së tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u garanton të gjithë qytetarëve, paanshmëri dhe profesionalizëm në organizimin e zgjedhjeve.
Andaj VOTO!

Refren (x2).

Kompozitorit gjatë kompozimit i lejohet që të bëjë ndonjë modifikim të lehtë me qëllim të krijimit të lidhjeve dhe rimave të mundshme në interpretim të melodisë.

Ky tekst duhet të interpretohet me anë të melodisë së instrumenteve muzikore.

Kompozimi i përzgjedhur do të shpërblehet me 5,000€.
Ndërsa do të shpërblehen edhe kompozimi i dytë me 2,000€ dhe i treti me 1,000€.

Për përzgjedhjen e melodisë do të caktohet një komision profesional.

Gjatë vlerësimet të përzgjedhjes së melodisë KQZ mund të kërkojë edhe ndonjë plotësim ndryshim eventual, para se të miratohet përfundimisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

KQZ-ja rezervon të drejtën që mos ta zgjedhë asnjërin nga propozimet nëse nuk janë kualitative dhe e përsërit procesin.

Kërkesat për kualifikim për kompozitorin:

Diplomë universitare në artet e muzikës.
Tre vite përvojë pune relevante.
Tre referenca për kompozime të suksesshme.

Kompozimi duhet të dorëzohet në formatin MP3 në USB ose CD.

Dëshmitë dhe kompozimi duhet të dorëzohen në adresën e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, Rr. Migjeni, nr. 21 Prishtinë 10000, Kosovë, deri në ora 16:00, të datës 21 gusht 2023.